



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në mbështetje të nenit 39 dhe nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10 dhe 123/12), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut mori

VENDIM

për përmbajtjen dhe mënyrën e funksionimit të Regjistrit të Kredive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 186/13)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përcaktohet përmbajtja dhe mënyra e funksionimit të Regjistrit të Kredive të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Regjistri i Kredive), duke përcaktuar:

- llojin e të dhënave dhe informacioneve të dërguara në Regjistrin e Kredive;
- mënyrën dhe afatet e dorëzimit të të dhënave dhe informacioneve në Regjistrin e Kredive;
- mënyrën dhe kushtet e përdorimit të të dhënave dhe informacioneve nga Regjistri i Kredive.

2. Regjistri i Kredive është një bazë e të dhënave dhe informacioneve për ekspozimin kreditor të bankave dhe kursimoreve në Republikën e Maqedonisë ndaj klientëve të tyre, qëllimi kryesor i të cilit është të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së kredive dhe ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar. Regjistri i Kredive është përmbledhje e të dhënave personale, kontrollues i të cilave është Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore).

Qëllimi i Regjistrit të Kredive është që të mundësojë:

- centralizimin e të dhënave dhe informacioneve për ekspozimin kreditor ndaj klientëve, të ofruar nga bankat dhe kursimoret;
- përdorimin e të dhënave dhe informacioneve për ekspozimin kreditor ndaj klientëve, nga bankat dhe kursimoret, për të menaxhuar rrezikun e kredive;
- përdorimin e të dhënave dhe informacioneve për ekspozimin kreditor ndaj klientëve, të bankave individuale dhe kursimoreve dhe sistemit bankar në tërësi, nga Banka Popullore, për të kryer funksionin mbikëqyrës.

3. Terma të caktuar të përdorur në këtë vendim kanë këto kuptime:

3.1. "Bankë" nënkupton bankat dhe degët e bankave të huaja të themeluara në Republikën e Maqedonisë në përputhje me Ligjin e Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10 dhe 26/13).

3.2. "Palë kredie" nënkupton çdo marrëveshje për ekspozimin kreditor që është lëndë klasifikimi, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për menaxhimin e rrezikut të kredisë.

3.3. "Shitës me pakicë" nënkupton tregtarët individualë dhe personat fizikë të cilët sipas Ligjit të Shoqërive Tregtare, nuk konsiderohen tregtarë.

3.4. Për termin "rezident" zbatohet kuptimi i përcaktuar sipas Ligjit të Veprimtarisë me Valuta ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11 dhe 135/11).

Për termat që nuk janë të përcaktuara në këtë vendim, zbatohet kuptimi i përcaktuar me rregulloren e Bankës Popullore për menaxhimin e rrezikut të kredisë.

II. LLOJI I TË DHËNAVE DHE INFORMACIONEVE TË DORËZUARA NË REGJISTRIN E KREDIVE

4. Bankat dhe kursimoret dërgojnë të dhëna dhe informacione në Regjistrin e Kredive, për:

- identifikimin e klientit (numri i amzës, numri tatimor, aktiviteti, selia etj.);
- ekspozimi sipas palës së kredisë (shuma, struktura, cilësia, kolaterali, qëllimi, etj.);
- harmonizimi i pozicionit valutor;
- qëllimi i kredisë së miratuar në valutë për rezidentët (për pagesë jashtë vendit dhe për pagesë në vend);
- shlyerje të detyrimeve;
- kërkesa të fshira;
- të dhëna dhe informacione të tjera në lidhje me llojin, qëllimin dhe karakteristikat e ekspozimit kreditor dhe/ose klientit.

Të dhënat dhe informacionet e paragrafit 1 të kësaj pike përcaktohen më hollësisht me Udhëzimin e pikës 13 të këtij vendimi, të cilin do ta miratojë guvernatori i Bankës Popullore.

5. Bankat dërgojnë të dhënat dhe informacionet për ekspozimin kreditor të pikës 4 të këtij vendimi, individualisht për të gjithë:

- bankat e vendit dhe të huajat;
- jorezidentët;
- institucionet jobankare financiare vendase;
- personat juridikë jofinanciarë vendas me ekspozim të përgjithshëm kreditor mbi 300.000 denarë; dhe
- personat fizikë vendas dhe tregtarët me pakicë, me ekspozim të përgjithshëm kreditor prej mbi 5.000 denarë.

Të dhënat dhe informacionet e pikës 4 të këtij vendimi, kursimoret janë të detyruara t'i dorëzojnë individualisht për të gjitha personat juridikë me ekspozim të përgjithshëm kreditor mbi 50.000 denarë dhe për të gjithë personat fizikë dhe shitësit me pakicë me ekspozim të përgjithshëm kreditor mbi 5.000 denarë.

Bankat dhe kursimoret paraqesin kolektivisht të gjitha ekspozimet që nuk i kalojnë kufijtë nga pikat 1 dhe 2 të kësaj pike, duke zbatuar rregullat e përcaktuara me udhëzimin nga pika 13 e këtij vendimi, të cilin do ta miratojë guvernatori i Bankës Popullore..

III. MËNYRA DHE AFATET E DORËZIMIT TË TË DHËNAVE DHE INFORMACIONEVE NË REGJISTRIN E KREDIVE

6. Bankat dhe kursimoret janë të detyruara të paraqesin të dhëna dhe informacione në Regjistrin e Kredive.

Të dhënat dhe informacionet e pikës 4 të këtij vendimi dërgohen në mënyrë elektronike, me ndihmën e aplikacionit të veçantë të përpunuar nga Banka Popullore.

7. Bankat dhe kursimoret janë përgjegjëse për saktësinë e të dhënave dhe informacionet e paraqitura në Regjistrin e Kredive.

Nëse klienti - personi fizik paraqet dëshmi në bankë ose në kursimore që të dhënat e tij personale në Regjistrin e Kredive janë të paplota, të pasakta ose të pa përditësuara, me kërkesën e tij me shkrim, banka ose kursimorja është e detyruar të plotësojë ose ndryshojë të dhënat, t'i fshijë dhe në të njëjtën kohë t'i zëvendësojë me të dhëna të sakta ose të ndalojë përdorimin e të dhënave jo të plota, të pasakta ose të papërditësuara dhe në të njëjtën kohë t'i zëvendësojë me të dhëna të sakta.

Bankat dhe kursimoret janë të detyruara të bëjnë zëvendësimin me të dhënat e sakta të paragrafit 2 të kësaj pike, në periudhën e parë pasuese të dorëzimit të të dhënave dhe informacioneve në Regjistrin e Kredive.

8. Afati i dorëzimit të të dhënave dhe informacioneve në Regjistrin e Kredive nga bankat dhe kursimoret përcaktohet në Udhëzimin e pikës 13 të këtij vendimi, të cilin do ta miratojë guvernatori i Bankës Popullore.

IV. MËNYRA DHE KUSHTET E PËRDORIMIT TË TË DHËNAVE DHE INFORMACIONEVE NGA REGJISTRI I KREDIVE

9. Qasësi në të dhënat dhe informacionet e Regjistrit të Kredive vërtetohet dhe qasja autorizohet dhe evidentohet.

10. Banka ose kursimorja mund të përdorë të gjitha të dhënat dhe informacionet nga Regjistri i Kredive, që kanë të bëjnë me ekspozimin e saj kreditor.

Banka ose kursimorja mund të përdorë të dhënat dhe informacionet e përmbledhura, të cilat më në hollësi përcaktohen me Udhëzimin e pikës 13 të këtij vendimi, të cilin guvernatori i Bankës Popullore do ta miratojë për klientët për të cilët ka raportuar ekspozim me gjendjen e datës së paraqitjes së fundit të të dhënave në Regjistrin e Kredive.

Banka ose kursimorja mund të përdorë të dhënat dhe informacionet e përmbledhura të paragrafit 2 të kësaj pike edhe për:

- personat ndaj të cilëve banka ose kursimorja nuk ka krijuar ekspozim kreditor, vetëm nëse këta persona kanë paraqitur kërkesë pranë bankës ose kursimoreve për miratimin e ekspozimit kreditor brenda një periudhe maksimale prej 30 ditësh përpara se banka ose kursimorja t'i drejtohet Regjistrin të Kredive, për të marrë të dhëna për këta persona dhe duhet të sigurojë dëshmi të dokumentuara;
- personat ndaj të cilëve banka ose kursimorja nuk ka krijuar ekspozim kreditor, por janë garantues, bashkëkredikërkues ose persona të lidhur me personat e nënparagrafit të mëparshëm të këtij paragrafi;
- personat ndaj të cilëve banka ose kursimorja nuk kanë krijuar ekspozim kreditor, por janë garantues, bashkëkredikërkues ose persona të lidhur me klientët ndaj të cilëve banka ose kursimorja ka krijuar ekspozim kreditor.

Bankat dhe kursimoret mund t'i përdorin të dhënat dhe informacionet nga Regjistri i Kredive vetëm nëse kanë dëshmi të dokumentuara të personave nga paragrafi 3, nënparagrafët 2 dhe 3 të kësaj pike.

11. Të dhënat dhe informacionet e përmbledhura nga Regjistri i Kredive të pikës 10 të këtij vendimi janë në dispozicion të bankave ose kursimoreve deri në afatin e përcaktuar në Udhëzimin e pikës 13 të këtij vendimi, i cili do të miratohet nga guvernatori i Bankës Popullore.

12. Të dhënat dhe informacionet nga Regjistri i Kredive paraqesin informacion të klasifikuar.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

13. Guvernatori i Bankës Popullore përcakton zbatimin e këtij vendimi, përkatësisht llojin, mënyrën dhe kushtet e dërgimit dhe përdorimit të të dhënave dhe informacioneve në/nga Regjistri i Kredive nga bankat dhe kursimoret.

14. Bankat dhe kursimoret janë të detyruara të caktojnë persona të autorizuar për dërgimin dhe përdorimin e të dhënave dhe informacioneve në/nga Regjistri i Kredive dhe të njoftojnë Bankën Popullore brenda pesë (5) ditëve pune nga data e emërimit.

Bankat dhe kursimoret janë të detyruara që, për çdo ndryshim të personave të paragrafit 1 të kësaj pike, ta njoftojnë Bankën Popullore në afat prej pesë (5) ditësh pune pas ndryshimit.

15. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon së vlefshmi Vendimi për përmbajtjen dhe mënyrën e funksionimit të Regjistrit të Kredive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 126/11).

16. Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

Me përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, dispozitat e pikës 4, nënpikat 4 dhe 5 të këtij vendimi do të zbatohen nga 1 dhjetori 2014.

V nr. 02-15/XIV-1/2013
26 dhjetor 2013
Shkup

Guvernatori
dhe kryesuesi
i Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov